

20232694635

**LIGJ I HUAMARRJES SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT ME HUA NË
BANKËN NDËRKOMBËTARE TË RINDËRTIMIT DHE TË ZHVILLIMIT – BANKA
BOTËRORE SIPAS MARRËVESHJES SË HUAS PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT
TË DYTË PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE**

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut merr hua në Bankën Ndërkombëtare të Rindërtimit dhe të Zhvillimit - Banka Botërore në vlerë prej 27.500.000 eurove, të caktuar për realizimin e Projektit të dytë të përmirësimit të shërbimeve sociale.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas së nenit 1 të këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshjen e huas për financimin e Projektit të dytë për përmirësimin e shërbimeve sociale, që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bankës Ndërkombëtare të Rindërtimit dhe të Zhvillimit – Banka Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Marrëveshjen e huas së paragrafit (1) të këtij neni, do ta nënshkruajë ministri i Financave.

Neni 3

Huaja e nenit 1 të këtij ligji do të tërhiqet në transhe, në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e huas.

Afati i pagesës së secilës transhe të huas së nenit 1 të këtij ligji është 11 vjet, me periudhë mospagimi të përfshirë prej tri vjetësh.

Norma e interesit është EURIBOR gjashtëmujor me interval variabil.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së huas të nenit 2 paragrafi (1) të këtij ligji, Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare të Rindërtimit dhe të Zhvillimit – Banka Botërore provizion të njëhershëm në vlerë prej 0.25% nga vlera e huas.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare të Rindërtimit dhe të Zhvillimit provizion në nivel vjetor në vlerë prej 0.25% të pjesës së patërhequr të huas.

Neni 4

Shfrytëzues i mjeteve të huas së nenit 1 të këtij ligji është Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale.

Neni 5

Republika e Maqedonisë së Veriut, huan e nenit 1 të këtij ligji do ta shlyejë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.